



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe**  
**Monitorimit**

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**“CAKTIMIN E NUMRIT TË MONITORUESVE PËR ZGJEDHJET E PJESHME**  
**PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024”**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË**  
**FUQI**

Neni 19, pikat 1, shkronja “ë” dhe 2, të ligjit 10019, datë 19.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhur me të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore si dhe nxjerrjen e akteve administrative në këtë drejtim.

Neni 92/4 i ligjit 10019, datë 19.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton monitorimin e fushatës zgjedhore.

Neni 5, pika 3 i udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, përcakton caktimin e numrit të monitoruesve në çdo zgjedhje dhe për çdo zonë me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të neneve 19, pika 1, shkronja “ë” e 2, 92/4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 5 të udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, në kuadër të ndryshimeve ligjore është hartuar projektvendimi “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Qëllimi i këtij projektvendimi është caktimi i numrit të monitoruesve për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.

Bazuar në numrin e qendrave të votimit në Bashkinë Himarë, Qarku Vlorë, (36 qendra votimi) si dhe referuar monitorimit të bërë për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023, caktohet 1 (një) monitorues për kryerjen e monitorimit në këtë bashki.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si dhe udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022,

të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”, shqyrton dhe miraton projektvendimin “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.

<b>Jona JOSIFI</b>	- Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit
<b>Madalena KOJA</b>	- Drejtoria e Ligjshmërisë
<b>Aurel LAMÇE</b>	- Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve
<b>Majlinda ÇELMETA</b>	-Sekretari i Përgjithshëm (në mungesë dhe me autorizim)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

VENDIM  
PËR

**CAKTIMIN E NUMRIT TË MONITORUESVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR  
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë”, nenit 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n” e 2, nenit 92/4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 5 të udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin”,

VENDOS:

- Caktimin e 1 (një) monitoruesi për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Kopje 3

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Afati i ruajtjes 5 vjet

Konceptoi: E.Podgorica \_\_\_\_\_

Miratoi: K.Puleri \_\_\_\_\_

Aprovoi: J.Josifi \_\_\_\_\_

M.Çelmeta \_\_\_\_\_

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



“Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”